



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR**

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 20.11.2020, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor.

BAZA LIGJORE: Neni 20, paragrafi 1 germa “a”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Rregullator pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Komisioneri, dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve, në zbatim të kompetencës së parashikuar në nenin 20, paragrafi 1, germa “a” të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ilirjana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

RREGULLORE

PËR
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ZONËS
SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe objekti

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është organizimi dhe funksionimi i punës dhe i mbledhjeve të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (më poshtë “KZAZ”), në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KZAZ-së, thirrjes dhe zhvillimit të mbledhjeve, marrjes së vendimeve, si dhe për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në Zonën e Administrimit Zgjedhor (më poshtë ZAZ), në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore të miratuara nga KQZ-ja.

Neni 2
Ligji dhe parimet në të cilat mbështetet veprimtaria e KZAZ-së

1. Veprimtaria e KZAZ-së mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe aktet nënligjore të miratuara nga KQZ-ja.
2. KZAZ përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ.
3. Veprimtaria e KZAZ-së bazohet në parimet e ligjshmërisë, kolegjalitetit, profesionalizmit, pavarësisë, paanësisë dhe transparencës.

KREU II
PËRBËRJA DHE NGRITJA E KZAZ-së

Neni 3
Përbërja e KZAZ-së

1. KZAZ-ja përbëhet nga 7 anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga Komisioneri Shtetëror i



- Zgjedhjeve (më poshtë “Komisioneri”).
2. Komisioneri drejton dhe mbikëqyr, drejtpërdrejt ose nëpërmjet administratës së KQZ-së, veprimtarinë e KZAZ-së.
 3. Procedura për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve është si më poshtë:
 - a) dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare, dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia e dytë e shumicës parlamentare dhe një anëtar propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare. Në rast se nuk arrihet baraspeshimi politik, sipas kësaj shkronje, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në baraspeshimin politik shumicë-opozitë;
 - b) anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse gjysma tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare, sipas kritereve objektive të bazuara në:
 - i) përzgjedhjen rastësore;
 - ii) shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor;
 - c) sekretari i KZAZ-së duhet të jetë jurist dhe propozohet nga partia, e cila propozon zëvendëskryetarin e KZAZ-së;
 - ç) 30 për qind e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga partia më e madhe e shumicës dhe partia më e madhe e opozitës, në shkallë vendi, duhet të jenë nga secila gjini.
 4. Partitë politike që kanë të drejtën të propozojnë anëtarët e KZAZ-së sipas parashikimeve të paragrafit 3 më sipër të këtij neni, paraqesin në KQZ, jo më vonë se 105 ditë përpara datës së zgjedhjeve propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve.
 5. Kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së zgjidhen nga Komisioneri, me propozim të KZAZ-së. Në KZAZ-të ku anëtari i shtatë i përket partisë kryesore të shumicës parlamentare, kryetar zgjidhet njëri nga anëtarët e KZAZ-së, përfaqësues i partisë kryesore të shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër zgjidhet njëri nga anëtarët e KZAZ-së, përfaqësues i partisë kryesore të opozitës parlamentare. Zëvendëskryetari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin.
 6. Renditja e partive për efekt të ndarjes së vendeve në KZAZ, sipas përcaktimeve të këtij neni, bëhet mbi bazën e numrit të mandateve që ka fituar partia politike nga zgjedhjet pararendëse për Kuvendin. Në rastin e zgjedhjeve vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare. Në rast se dy ose më shumë parti kanë të njëjtin numër mandatesh dhe nuk është e mundur të përcaktohet partia përfituese, renditja e tyre përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi. Nëse dy ose më shumë parti kanë të njëjtin numër votash, renditja përcaktohet nga Komisioneri me short sipas parashikimeve të nenit 5 të kësaj Rregullore.
 7. Nëse partitë politike të shumicës parlamentare dhe të opozitës parlamentare, që kanë të drejtë të paraqesin kandidatura për KZAZ, nuk e ushtrojnë këtë të drejtë në afatin e përcaktuar në paragrafin 4 të këtij, kjo e drejtë u kalon automatikisht partive që vijnë në radhë me numër vendesh në Kuvend pas të parave, brenda grupimit përkatës. Kur kjo nuk është e mundur, propozimet bëhen sipas paragrafit 3, shkronja “a” të këtij neni. Nëse edhe këto parti nuk propozojnë anëtarë, Komisioneri emëron kryesisht anëtarët e KZAZ-së deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje.
 8. Nëse partitë politike që kanë të drejtë të paraqesin kandidatura për sekretarë në KZAZ sipas parashikimeve të paragrafit 3, shkronja “c”, të këtij neni, nuk e ushtrojnë këtë të drejtë në afatin e përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, Komisioneri emëron kryesisht sekretarët e KZAZ-së.
 9. Anëtarët dhe sekretarët e emëruar kryesisht qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të propozuar nga partitë politike, sipas këtij neni. Zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë



Miratuar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr.5, datë 20.11.2020, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”

se 30 ditë nga dita e zgjedhjeve. Në rastin e zgjedhjeve të parakohshme, zëvendësimi kryhet jo më vonë se 5 ditë nga dita e zgjedhjeve. Procedurat për përzgjedhjen dhe trajnimin e shtetasve që mund të emërohen kryesisht përcaktohen nga Komisioni Rregullator.

10. Në rastet e zgjedhjeve të pjesshme ose të parakohshme, KZAZ-ja ngrihet jo më vonë se 10 ditë nga data e nxjerrjes së dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve.
11. Kur vendi i një anëtari të KZAZ-së mbetet vakant, ai plotësohet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë nen brenda 15 ditëve nga data e krijimit të vakancës. Gjatë periudhës së zgjedhjeve, vendet vakante plotësohen brenda 3 ditëve.
12. Kur vendi i një anëtari ose sekretarit të KZAZ-së mbetet vakant në ditën e zgjedhjeve, propozimi në KQZ duhet të dorëzohet jo më vonë 3 orë nga çasti i krijimit të vakancës. Në rast se subjektet me të drejtë propozimi nuk propozojnë kandidaturë në KQZ, kjo e drejtë i kalon partive politike të të njëjtit grupim që vijnë pas tyre në Kuvend për nga numri i vendeve të fituara në Kuvend në zgjedhjet pararendëse. Nëse edhe këto parti nuk propozojnë anëtarë, Komisioneri emëron kryesisht anëtarët e KZAZ-së deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje dhe sekretarin e KZAZ-së me qëllim funksionimin normal të tij.

Neni 4

Shorti për caktimin e partisë politike që propozon anëtarin e shtatë të KZAZ-së

1. Komisioneri, për zbatimin e kriterëve të parashikuara në nenin 3, paragrafi 1, gërma “b”, të kësaj rregullore, organizon në seancë publike hedhjen e shortit ndërmjet partisë kryesore të shumicës parlamentare dhe partisë kryesore të opozitës parlamentare.
2. Emrat e partive politike pjesëmarrëse në short, data, vendi dhe ora e zhvillimit të shortit publikohen në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së dhe shpallen në këndin njoftime, në hyrje të godinës së KQZ-së.
3. Procesi i hedhjes së shortit zhvillohet nga administrata e KQZ-së, në prani të përfaqësuesve të partisë kryesore të shumicës parlamentare dhe partisë kryesore të opozitës parlamentare, përfaqësuesve të partive të politike të akredituar në KQZ, dhe përfaqësuesve të mediave.
4. Në datën dhe në orën e caktuar për zhvillimin e shortit, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së sigurohet paraprakisht për praninë e përfaqësuesve të partive politike pjesëmarrëse në short, dhe i fton të zenë vendet e caktuara.
5. Mosparaqitja e ndonjë prej përfaqësuesve të partive politike pjesëmarrëse në short, pasi njoftimet janë publikuar sipas paragrafit 2 të këtij neni, nuk pezullon procedurat e shortit. Në këtë rast Komisioneri, me vendim të ndërmjetëm, cakton një punonjës të administratës së KQZ-së, të tërheqë shortin për partinë politike, përfaqësues i së cilës nuk është prezent.
6. Procedura e shortit:
 - a) për efekt të shortit:
 - i. zonat e administrimit zgjedhor mbajnë numërtimin sipas përcaktimeve të vendimit të Rregullatorit;
 - ii. në KZAZ-të e ZAZ-ve me numër tek, anëtari i shtatë do të propozohet nga njëra prej partive që merr pjesë në short dhe në KZAZ-të e ZAZ-ve me numër çift, anëtari i shtatë do të propozohet nga partia tjetër;
 - b) emrat e partive pjesëmarrëse në short shkruhen në shirita letre, të cilët mbyllen në dy gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë dhe vendosen në një enë transparente;
 - c) dy shirita letre ku në shiritin e parë shkruhet “KZAZ-të e numërtuara me numër tek” dhe në shiritin tjetër “KZAZ-të e numërtuara me numër çift”, mbyllen në dy gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë dhe vendosen në një enë të dytë transparente;



- c) një nëpunës i administratës së KQZ-së, tërheq njëri nga goglat që ndodhen në enën e parë;
- d) përfaqësuesi i partisë, emri i së cilës ndodhet në shiritin e letrës brenda goglës së tërhequr nga ena e parë, tërheq i pari njëri nga dy goglat në enën e dytë. Në mungesë të përfaqësuesit të partisë përkatëse, Komisioneri cakton një punonjës të administratës për të tërhequr njëri nga goglat në enën e dytë;
- dh) partisë politike, përfaqësuesi i së cilës tërhoqi goglën në enën e dytë, i lind e drejta të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve sipas përcaktimit në shiritin e letrës që ndodhet brenda goglës së tërhequr (tek ose çift).

7. Komisioneri shpall me vendim rezultatin e shortit.

Neni 5

Shorti për renditjen e partive që kanë të njëjtin numër mandatesh dhe votash të fituara në shkallë vendi në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin

1. Komisioneri, për zbatimin e parashikimeve të paragrafit 6, të nenit 3 të kësaj rregullore, organizon në seancë publike hedhjen e shortit ndërmjet partive politike që kanë fituar të njëjtin numër mandatesh dhe kanë të njëjtin numër votash në shkallë vendi në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin.
2. Emrat e partive politike pjesëmarrëse në short, data, vendi dhe ora e zhvillimit të shortit publikohen në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së dhe shpallen në këndin njoftime, në hyrje të godinës së KQZ-së.
3. Procesi i hedhjes së shortit zhvillohet nga administrata e KQZ-së nën mbikëqyrjen e Komisionerit, në prani të përfaqësuesve të partive politike që marrin pjesë në short, përfaqësuesve të partive të politike të akredituar në KQZ, dhe të mediave.
4. Në datën dhe në orën e caktuar për zhvillimin e shortit, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së sigurohet paraprakisht për praninë e përfaqësuesve të partive politike pjesëmarrëse në short, dhe i fton të zenë vendet e caktuara.
5. Mosparaqitja e ndonjë prej përfaqësuesve të partive politike pjesëmarrëse në short, pasi njoftimet janë publikuar sipas paragrafit 2 të këtij neni, nuk pezullon procedurat e shortit. Në këtë rast Komisioneri, me vendim të ndërmjetëm, cakton një punonjës të administratës së KQZ-së, të tërheqë shortin për partinë politike, përfaqësues i së cilës nuk është prezent.
6. Procedura e shortit:
 - a) emrat e partive pjesëmarrëse në short shkruhen në shirita letre. Secili nga shiritat e letrës ku janë shënuar emrat e partive politike pjesëmarrëse në short mbyllet në gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë dhe vendosen në një enë transparente;
 - b) në një enë të dytë transparente futen aq gogla, me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë, sa është edhe numri i partive politike pjesëmarrëse në short. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letre, ku shënohet një nga numrat rendorë duke filluar nga numri një deri tek numri i barabartë me numrin e partive politike, pjesëmarrëse në short.
 - c) një nëpunës i administratës së KQZ-së, tërheq njëri pas tjetrës goglat që ndodhen në enën e parë, i hap, lexon emrin e partisë politike që është shënuar në shiritin brenda goglës dhe ia jep Komisionerit. Sekretari i KQZ-së mban shënim rezultatet e parashortit.
 - ç) përfaqësuesit e partive, në radhën e përcaktuar nga parashorti i hedhur sipas parashikimeve të shkronja "c" të këtij paragrafi, tërheqin njëri nga goglat në enën e dytë, e hapin, lexojnë numrin e shënuar në të, dhe ja japin Komisionerit. Sekretari i KQZ-së mban shënim numrat e lexuar nga secili përfaqësues i partive politike pjesëmarrëse në short.



Miratuar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr.5, datë 20.11.2020/Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor"

7. Komisioneri, në përfundim të procedurave të shortit sipas paragrafit 6 të këtij neni, shpall me vendim, sipas rezultatit të shortit, renditjen e partive politike për efekt të ndarjes së vendeve në KZAZ.

Neni 6

Paraqitja e propozimeve për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-së

1. Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve depozitojnë në KQZ listën me propozimet dhe dokumentacionin përkatës për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve në shkallë vendi, jo më vonë se 105 ditë nga data e zgjedhjeve.
2. Lista, e cila paraqitet në letër dhe format elektronik, përmban emrin dhe logon e partisë politike, kandidaturat e renditura sipas KZAZ-së përkatëse. Lista nënshkruhet nga përfaqësuesi i partisë parlamentare në KQZ apo personi përgjegjës për komunikim me KQZ.
3. Për çdo kandidaturë pasqyrohet emri, atësia, mëmësia, mbiemri, gjinia, arsimit, numri i ID dhe kontakti (numer telefoni celular).
4. 30 për qind e anëtarëve të propozuar nga partia më e madhe e shumicës dhe partia më e madhe e opozitës parlamentare e në shkallë vendi duhet të jenë nga secila gjini.
5. Për çdo kandidaturë të propozuar, bashkëlidhur listës paraqitet dokumentacioni:
 - a) certifikatë personale lëshuar nga zyra e gjendjes civile, ose nga portali e-albania;
 - b) kopje të noteruar të diplomës së arsimit të lartë. Propozimi për sekretar të KZAZ duhet të shoqërohet me diplomën e arsimit juridik;
6. Shtetasit e interesuar për t'u emëruar kryesisht anëtarë apo sekretarë të KZAZ-së, jo më vonë se 130 ditë para datës së zgjedhjeve depozitojnë në KQZ kërkesën për shprehje interesi dhe dokumentacionin sipas njoftimit publik të Komisionerit.

Neni 7

Veprimet procedurale për emërimin e të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-së

1. Administrata e KQZ-së kryen verifikimin e të dhënave të kandidatuarave të paraqitura për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve.
2. Objekti i verifikimit është plotësimi i kushteve të përcaktuara në nenin 29 pika 1, gërma "c" dhe "ç", nenin 30 dhe nenin 31, të Kodit Zgjedhor.
3. Administrata e KQZ-së i paraqet Komisionerit dhe Nënkomisionerit raport për rezultatet e verifikimit, si rregull jo me vonë se 4 ditë nga dorëzimi i propozimeve nga partitë politike apo nga përfundimi i afatit për shprehje interesi nga shtetasit për emërim kryesisht anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-së.
4. Partia politike, jo më vonë se 24 orë nga njoftimi i Komisionerit për mangësi të propozimeve apo dokumentacionit të paraqitur, plotëson mangësitë ose rideponon propozim për zëvendësim të kandidaturës.
5. Komisioneri, jo më vonë se 93 ditë nga data e zgjedhjeve emëron anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve.
6. Komisioneri, jo më vonë se 90 ditë nga data e zgjedhjeve, kur partitë politike sipas parashikimeve të nenit 3 të kësaj rregulloreje nuk kanë propozuar anëtarë apo sekretarë të KZAZ-ve, emëron kryesisht anëtarët e KZAZ-së deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje dhe/ose emëron kryesisht sekretarin e KZAZ-së.

Neni 8

Ngritja e KZAZ-ve dhe thirrja e mbledhjes së parë të tyre



Miraturar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr.5, datë 20.11.2020 "Për miratimin e rregullore për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor"

1. Vendim për ngritjen e KZAZ-ve merret nga Komisioneri jo më vonë se 90 ditë para datës së zgjedhjeve.
2. Vendimi i Komisionerit për ngritjen e KZAZ-ve përcakton njësinë administrative, selinë dhe orën ku do të zhvillohet mbledhja e parë të KZAZ-ve.
3. Vendimi i Komisionerit për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të KZAZ-ve bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të KQZ, dhe njoftohet në media.
4. Komisioneri i dërgon partive politike të cilat kanë propozuar anëtarët e KZAZ-ve njoftim për datën, vendin dhe orën e mbledhjes së parë të KZAZ-së.

Neni 9

Emërimi i kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZAZ-së

1. KZAZ-ja në mbledhjen e parë me vendim propozon kryetarin dhe zv.kryetarin e KZAZ-së.
2. Në KZAZ-të ku anëtari i shtatë i përket partisë kryesore të shumicës parlamentare, kryetar zgjidhet njëri nga anëtarët e KZAZ-së, përfaqësues i partisë kryesore të shumicës parlamentare. Në këto KZAZ, të drejtën e propozimit për kryetarin e ka njëri nga anëtarët e propozuar nga partia kryesore e shumicës parlamentare.
3. Në gjysmën tjetër të KZAZ-ve kryetar zgjidhet njëri nga anëtarët e KZAZ-së, përfaqësues i partisë kryesore të opozitës parlamentare. Në këto KZAZ, të drejtën e propozimit për kryetarin e ka njëri nga anëtarët e propozuar nga partia kryesore e opozitës parlamentare.
4. Zëvendëskryetari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin. Të drejtën e propozimit për zëvendëskryetarin e ka, njëri nga anëtarët e propozuar nga partia politike që i përket zëvendëskryetari.
5. Propozimet paraqiten me shkrim, të firmosur nga anëtarët e KZAZ-së që mbështesin propozimin përkatës.
6. Të gjithë anëtarët e KZAZ-së janë të detyruar të votojnë pro propozimit për emërimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZAZ-së.
7. Vendimet e KZAZ-së për propozimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit i dërgohen menjëherë Komisionerit.
8. Komisioneri emëron kryetarët dhe zëvendëskryetarët e KZAZ-ve sipas propozimeve të KZAZ-së.
9. Anëtari i emëruar kryesisht për plotësim të vakancës në KZAZ nuk mund të propozohet dhe as të emërohet kryetar apo zëvendëskryetar i KZAZ-së.

Neni 10

Shkarkimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZAZ-së

1. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së shkarkohen nga detyra me vendim të Komisionerit, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, kur:
 - a) shkelin dispozitat e Kodit Zgjedhor ose të akteve nënligjore të KQZ-së lidhur me detyrat e KZAZ-së;
 - b) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - c) mungojnë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht të KZAZ-së;
 - ç) nuk paraqiten në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht në periudhën zgjedhore;



- d) nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.
2. Kërkesa e subjekteve zgjedhore për shkarkimin e anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së, paraqitet me shkrim dhe duhet të përmbajë argumente dhe fakte për shkeljen e pretenduar.
 3. Çdo anëtar apo sekretari i KZAZ-së, njofton Komisionerin nëse një anëtar apo sekretari i KZAZ-së është të paktën në një nga kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni. Njoftimi paraqitet i nënshkruar me argumente dhe fakte për shkeljen e pretenduar.
 4. Kundër vendimit të Komisionerit për shkarkimin nga detyra të anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së, lejohet ankim në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit.
 5. Anëtari apo sekretari i KZAZ-së i shkarkuar nga detyra me vendim të Komisionerit, nuk mund të emërohet më në përbërje të KZAZ-së, kur KAS-i në përfundim të shqyrtimit administrativ ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit.
 6. Komisioneri njofton subjektin përkatës të dorëzojë në KQZ, brenda tre ditëve gjatë periudhës zgjedhore, dhe brenda tre orëve në ditën e zgjedhjeve, propozimin dhe dokumentacionin për vendin vakant të anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së.

Neni 11

Lirimi nga detyra i anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së

1. Anëtari ose sekretari i KZAZ-së lirohet nga detyra me vendim të Komisionerit, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, kur:
 - a) janë në marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;
 - b) janë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumemërore të subjekteve zgjedhore që konkurrojnë në zonë;
 - c) nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës;
 - ç) nuk kanë më vendbanimin e tyre në zonën zgjedhore;
 - d) subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre;
- dh) kërkesa e subjektit zgjedhor për zëvendësimin e anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së pranohet në çdo rast. Kërkesa shoqërohet me propozimin dhe dokumentacionin përkatës për anëtarin ose sekretarin zëvendësues;
- e) kërkesat e partive kryesore të shumicës dhe opozitës parlamentare, për zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së, në çdo rast nuk duhet të çënojnë kuotën e përfaqësimit gjinor sipas nenit 3, paragrafi 2, germa “ç” të kësaj rregullore.
- ë) çdo anëtar i KZAZ-së, njofton Komisionerin në rastet kur anëtari apo sekretari i KZAZ-së është në një nga kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni. Njoftimi paraqitet i nënshkruar, me argumente dhe fakte, dhe sipas rastit i shoqëruar me dokumentacion që provon ekzistencën e kushteve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 12

Dorëzimi i detyrës

1. Anëtari apo sekretari i KZAZ-së i shkarkuar, liruar apo dorëhequr nga detyra, nuk mund të largohet nga KZAZ-ja, pa dorëzuar detyrën tek zëvendësuesi i tij.



Miraturar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr.5, datë 20.11.2020 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor"

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

2. Kur anëtari apo sekretari i KZAZ-së jep dorëheqjen, deklarata e dorëheqjes depozitohet në KZAZ.
3. Sekretari i KZAZ-së bën shënimet përkatëse në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së dhe menjëherë njofton KQZ-së dhe degën lokale të partisë përkatëse për krijimin e vakancës. Sekretari i bashkëngjit detyrimisht njoftimit një kopje të deklaratës së dorëheqjes.
4. Komisioneri njofton subjektin përkatës të dorëzojë në KQZ, brenda tre ditëve gjatë periudhës zgjedhore, dhe brenda tre orëve në ditën e zgjedhjeve, propozimin dhe dokumentacionin për vendin vakant të anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së.

KREU III

TË DREJTAT DHE DETYRAT E ANËTARIT TË KZAZ

Neni 13

Të drejtat e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së

1. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së përfitojnë shpërblimin për punën e bërë. Masa e shpërblimit caktohet me vendim të Komisionerit.
2. Gjatë kohës që anëtari dhe sekretari i KZAZ-së ushtron detyrën nuk humbet të drejtat dhe detyrat në vendin e tij të punës.
3. Anëtari i KZAZ ka të drejtë të njihet me rendin e ditës dhe me materialet së mbledhjes së KZAZ-së, si rregull jo më vonë se 2 orë përpara zhvillimit të mbledhjes.
4. Çdo anëtar dhe sekretari i KZAZ-së ka të drejtë të komunikojë dhe informojë Komisionerin, përmes administratës së KQZ-së, për çdo problem që vlerëson të arsyeshëm.
5. Sekretari i KZAZ-së merr pjesë në mbledhjet e KZAZ-së, diskuton dhe jep mendimin e tij për çështje që shqyrtohen, si anëtar pa të drejtë vote.

Neni 14

Detyrat e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së

1. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së gjatë ushtrimit të detyrës është i detyruar:
 - a) të zbatojë me përpikmëri Kodin Zgjedhor, aktet e KQZ-së, dhe vendimet e KZAZ-së;
 - b) të paraqitet rregullisht në detyrë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Rregullore, me përjashtim të rasteve kur për arsye objektive dhe me njoftim paraprak të Kryetarit të KZAZ-së, nuk mund të jenë të pranishëm;
 - c) të deklarojë menjëherë rastet e marrëdhënies së krushqisë të afërt ose gjinisë deri në shkallë të katërt, apo të marrëdhënies së punës me ndonjërin nga kandidatët që konkurojnë në zonë;
 - ç) të veprojë në mënyrë të paanshme për zbatimin e detyrave, vendimeve të KQZ dhe KZAZ-së;
 - d) të mos lejojë që interesat private të bien ndesh me detyrën, të shmangë konfliktin e interesit dhe të mos shfrytëzojë detyrën për interesin privat;
 - dh) të zbatojë dhe të respektojë normat e njohura dhe të gjithëpranuara të etikës në komunikim dhe sjellje;
 - e) të jetë i ndershëm në kryerjen e detyrave, i përkushtuar dhe korrekt, duke patur parasysh vetëm interesin publik.
2. Sekretari i KZAZ-së kryen këto detyra:
 - a) përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KZAZ-së;
 - b) protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KZAZ-së përmes regjistrimit dhe shënimeve



Miratuar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr.5, datë 20.11.2020 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor"

- përkatëse në Regjistrin e Korespondencës së KZAZ-së si dhe regjistron aktet apo dokumentacion që dalin prej saj, duke plotësuar të dhënat sipas rubrikave përkatëse;
- c) mban dokumentacionin zgjedhor të arkivuar;
 - ç) përgatit, në përputhje me udhëzimet e kryetarit, materialet për mbledhjen e KZAZ-së dhe ua shpërndan ato anëtarëve;
 - d) mban procesverbalet e mbledhjeve të KZAZ-së në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së ku do të pasyrojë veprimtarinë e KZAZ-së është përgjegjës për administrimin e tij;
 - dh) kryen zbardhjen e vendimeve të marra nga KZAZ-ja dhe i vulos ato sipas modelit të miratuar nga KQZ brenda 24 orëve nga marrja e vendimit;
 - e) regjistron në protokoll (përmes regjistrimit në regjistrin e vendimeve) vendimet e KZAZ-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara;
 - ë) u jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KZAZ-së ose procesverbaleve të mbledhjeve të saj;
 - f) regjistron në protokoll (përmes shënimeve në Librin e Protokollit të Mbledhjeve) marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore të dërguara nga KQZ-ja, sipas nenit 99 të Kodit Zgjedhor dhe kujdeset për administrimin teknik dhe kushtet e ruajtjes së tyre, në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor;
 - g) me kërkesë të zgjedhësve, lëshon vërtetime nëse emri i zgjedhësit gjendet ose jo në listat përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor;
 - gj) regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin komisionit;
 - h) bashkërendon me Policinë e Shtetit masat për rendin publik në funksion të zgjedhjeve;
 - i) administron dokumentacionin zyrtar për ndërhyrjet e policisë në rivendosjen e rendit publik, kur jashtë qendrës së votimit rrezikohet rendi ose pengohet procesi i rregullt i votimit;
 - j) dokumenton çdo ndërhyrje të Policisë së Shtetit sipas rasteve të parashikuara në nenin 109 të Kodit Zgjedhor;
 - k) është përgjegjës për administrimin dhe përdorimin e vulës së KZAZ-së, dhe njoftimin e menjëhershëm të rasteve të dëmtimit apo humbjes së vulës së KZAZ-së;
 - l) jep asistencë juridike për KZAZ-në;
 - ll) regjistron në Librin e Protokollit mospërputhje të konstatuara nga KZAZ gjatë marrjes në dorëzim të materialeve të votimit nga KQV-të në KZAZ. Regjistron në Procesverbalin e Konstatimit parregullsitë, pasaktësitë e konstatuara gjatë procesit të numërimit të votave.

KREU IV DETYRAT DHE FUNKSIONIMI I KZAZ-së

Neni 15

Detyrat e KZAZ-së

1. KZAZ-ja kryen këto detyra:

- a) përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ, sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja;
- b) mbikëqyr dhe bashkëpunon në përgatitjen dhe përshtatjen e mjediseve të qendrave të votimit, dhe sipas rastit, përshtatjen dhe aksesueshmërinë e tyre për zgjedhësit me aftësi të kufizuara si dhe mban të informuar KQZ-në për kushtet e ndërtesave dhe ambienteve ku janë caktuar Qendrat e Votimit;
- c) bashkëpunon me organet e qeverisjes vendore, për vënien në dispozicion të ambienteve dhe bazës së nevojshme logjistike, për funksionimin e KZAZ-së, KQV-ve dhe VNV-së;



- ç) nën drejtimin e Kryetarit, harton planin e veprimeve të KZAZ-së ku parashikon veprimtaritë, afatet kohore të realizimit të tyre, ndarjen e detyrave mes anëtarëve;
- d) emëron kryetarin, zëvendëskryetarin, anëtarët, sekretarët e KQV-ve, dhe anëtarët e grupeve të numërimit, të përfshira në juridiksionin e ZAZ-së, sipas Kodit Zgjedhor;
- dh) merr masa për mbarëvajtjen e programeve të trajnimit të organizuar nga KQZ-ja, njofton anëtarët KQV-ve dhe GNV-ve për vendin, datën dhe orën e sesioneve të trajnimit, si dhe monitoron, mbikqyr dhe dërgon informacion në KQZ për pjesëmarrjen e anëtarëve të KQV-ve dhe GNV-ve;
- e) regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe, sipas rastit, verifikon informacionet ose pretendimet e subjekteve zgjedhore në zonë;
- ë) afishon në një vend të dukshëm listat përfundimtare të zgjedhësve, dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve dhe të dhëna të tjera, që lidhen me zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ si dhe përgjigjet për shpërndarjen dhe monitorimin për afishimin në çdo qendër votimi të materialeve informuese dhe edukuese të dërguara nga KQZ-ja, në gjuhën shqipe dhe sipas rastit në gjuhë të pakicave kombëtare;
- f) administron buxhetin e caktuar nga KQZ-ja;
- g) merr në dorëzim materialet zgjedhore të dërguara nga KQZ-ja, sipas nenit 99 të Kodit Zgjedhor dhe përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e tyre, në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor;
- gj) garanton shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit;
- h) merr në dorëzim nga KQV-të materialet e votimit dhe kutitë e votimit me fletët e votimit;
- i) përgatit dhe miraton tabelën përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për çdo subjekt zgjedhor në ZAZ dhe ia dërgon atë KQZ-së, së bashku me materialet e tjera të nevojshme, në përputhje me nenin 122 të Kodit Zgjedhor;
- j) regjistron kandidatin për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe listën e kandidatëve për këshillin vendor në rastet kur juridiksioni territorial i KZAZ-së është i njëjtë me territorin administrativ të bashkisë pasi kanë marrë vendimin e Komisionerit për vazhdimin e procedurave të regjistrimit pas verifikimit të kryer nga ana e tij në lidhje me pastërtinë e figurës së kandidatëve në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. KZAZ-ja brenda 48 orëve, dorëzon në KQZ, kopje vendimit të regjistrimit të kandidatëve për kryetar dhe kopje të vendimeve për regjistrimin e listave të kandidatëve për këshillin bashkiak si edhe kopje të listës;
- k) shpall kandidatët fitues për kryetar të njësisë vendore;
- l) informon KQZ-në për qendrat e votimit ku janë të rregjistruar zgjedhës që i përkasin pakicave kombëtare, numrin në total të tyre dhe sipas përkatësisë, jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve;
- ll) mbikqyr, verifikon dhe informon për masat për sigurimin dhe ruajtjen e materialeve zgjedhore në KZAZ dhe KQV deri në përfundim të procesit të votimit;
- m) merr masa për krijimin në VNV të një vendi/hapësire të përshtatshme që të jetë e shikueshme nga të gjithë vëzhguesit e akredituar, ku do të afishohen kopje të tabelës së rezultatit të qendrave të votimit, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, dhe kopje të tabelës përmbledhëse të rezultatit të ZAZ-së, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së;
- n) merr masa dhe është përgjegjëse për moslejimin e personave të tjerë në Vendin e Numërimit të Votave, përveç atyre të parashikuar në paragrafin 1 të nenit 121 të Kodit Zgjedhor. Në rast të pranisë së personave të tjerë, përveç atyre sipas paragrafit 1 të nenit 121 të Kodit Zgjedhor, KZAZ-ja me vendim, njofton menjëherë punonjësit e Policisë së Shtetit. Rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, duke përfshirë edhe orën e saktë të ardhjes dhe largimit të punonjësve të Policisë së Shtetit.



Miraturar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr.5, datë 20.11.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”

Neni 16
Selia e KZAZ-së

1. Në selinë e KZAZ-së, në vend të dukshëm vendoset flamuri kombëtar.
2. Në hyrje të ndërtesës ku është vendosur selia e KZAZ-së, vendoset tabela treguese e KZAZ-së e cila përmban numrin e Zonës së Administrimit Zgjedhor, emrat e anëtarëve të KZAZ-së, orarin e punës, numri i telefonit dhe adresën e postës elektronike të KZAZ-së.
3. Selia e KZAZ-së është e pajisur me linjë telefonike të rrjetit fiks dhe shërbim interneti.

Neni 17
Dokumenti i identifikimit

1. Gjatë ushtrimit të detyrës anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së, janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit të funksionit që ata kanë.
2. Vëzhguesit e akredituar në KZAZ, gjatë qëndrimit në mjediset e punës së KZAZ-së, janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit të lëshuar sipas rastit nga KQZ ose KZAZ, dhe të kenë kartën e identitetit.

Neni 18
Vula e KZAZ-së dhe përdorimi

1. KZAZ-ja gjatë kohës së funksionimit përdor vulën e dërguar nga KQZ-ja.
2. Vula e KZAZ-së mbahet nga Sekretari, i cili e administron atë në përputhje me Kodin Zgjedhor, aktet e KQZ-së dhe VKM nr. 390, datë 6.08.1993 "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare".
3. Vula e KZAZ-së vendoset në të gjitha aktet e nxjerra dhe të miratuara nga KZAZ-ja.
4. Vula nuk mund të nxirret për asnjë arsye jashtë ambienteve të punës së KZAZ-së.
5. Në rast se vula e KZAZ-së bëhet e papërdorshme, KZAZ-ja mban procesverbal në Librin e Protokollit në të cilin pasqyron rrethanat, shkaqet e pamundësisë së përdorimit të vulës dhe njofton Komisionerin. Njoftimit i bashkëngjitet kopja e procesverbalit dhe një letër e bardhë ku vulozet me vulën që deklarohet e dëmtuar, e cila është nënshkruar nga Sekretari i KZAZ-së.
6. Në rast se vula e KZAZ-së humbet, fakti pasqyrohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe njoftohen menjëherë organet e policisë dhe Komisioneri. Njoftimit që i dërgohet Komisionerit i bashkëngjitet kopja e procesverbalit dhe kopja e njoftimit të organeve të policisë.
7. Komisioneri, pas shqyrtimit të informacionit, vendos për pajisjen e KZAZ-së me vulë të re.

Neni 19
Koha e punës së KZAZ-së

1. Nga momenti i ngritjes së KZAZ-së deri tre ditë para datës së zgjedhjeve, orari i punës së KZAZ-së është paradite 09.00-13.00 dhe mbasdite 16.00 - 20.00. Për nevoja të kryerjes së detyrave në respektim të afateve, orari i punës mund të zgjatet me vendim të KZAZ-së.
2. Tre ditë para datës së zgjedhjeve deri në nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve dhe dorëzimin në KQZ të materialeve të votimit, KZAZ-ja qëndron në mënyrë të përhershme në detyrë. Ndërpretja dhe



Miratuar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr.5, datë 20.11.2020 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor"

rifillimi i punës, në çdo rast, bëhet me vendim të KZAZ-së.

3. Sekretari i KZAZ-së shënon në procesverbal kohën e ndërprerjes dhe rifillimit të punës.

KREU V MBLEDHJET E KZAZ

Neni 20

Mbledhja e parë e KZAZ-së

1. Mbledhja e parë e KZAZ-së thirret me vendim të Komisionerit.
2. Sekretari dhe anëtarët e KZAZ-së paraqiten në ambientin ku është caktuar Selia e KZAZ-së një orë përpara orës së njoftuar për thirrjen e mbledhjes, marrin në dorëzim dhe përgatisin ambientin.
3. Mbledhja e parë e KZAZ-së drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.

Neni 21

Mbledhjet e KZAZ-së

1. Mbledhjet e KZAZ-së janë publike dhe zhvillohen vetëm në ambientet e punës së saj.
2. Mbledhjet e KZAZ-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të KZAZ-së.
3. Mbledhjet e KZAZ-së thirren nga kryetari.
4. Njoftimi për mbledhjen e KZAZ-së vendoset në hyrje të zyrës së KZAZ-së të paktën 24 orë përpara orës së mbledhjes dhe përmban datën, orën, çështjet që do të diskutohen.
5. Sekretari është përgjegjës për përgatitjen e materialeve të mbledhjes, njoftimin e anëtarëve të KZAZ-së dhe afishimin e njoftimit sipas paragrafit 4 të këtij neni.
6. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të KZAZ-së, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një orë tjetër, të paktën dy orë pas të parës.

Neni 22

Zhvillimi i mbledhjes së KZAZ-së

1. Mbledhja e KZAZ-së drejtohet nga kryetari dhe në mungesë të tij nga zëvendëskryetari.
2. Drejtuesi i mbledhjes paraqet çështjen që është për shqyrtim dhe i jep fjalën anëtarëve për të diskutuar.
3. Çdo anëtar i KZAZ-së diskuton dhe paraqet propozime për çështje që janë në rendin e ditës. Ndalohet ndërprerja e fjalës së anëtarit që diskuton dhe komentet.
4. Gjatë mbledhjes së KZAZ-së, anëtarëve, sekretarit dhe pjesëmarrësve u ndalohet çdo lloj komunikimi me telefon ose forma të tjera komunikimi me të tretët.
5. Sekretari i KZAZ-së, për çdo rast, mban procesverbal në Librin e Protokollit të Mbledhjeve së KZAZ-së, i cili duhet të përmbajë:
 - a) datën, vendin dhe orën e mbledhjes;
 - b) anëtarët që morën pjesë;



Miratuar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr.5, datë 20.11.2020 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor"

- c) çështjet që u diskutuan;
 - ç) përmbajtjen e diskutimeve;
 - d) vendimet që u morën;
 - dh) rezultati i votimit të anëtarëve të KZAZ-së.
6. Procesverbali i mbledhjes i mbajtur në Librin e Protokollit të Mbledhjeve firmoset në çdo faqe nga sekretari dhe anëtarët e KZAZ-së që kanë marrë pjesë në mbledhje dhe vuloset nga sekretari me vulën e KZAZ-së.

KREU VI VENDIMET E KZAZ-SË

Neni 23

Mbyllja e diskutimeve dhe votimi i propozimeve

1. Mbyllja e diskutimeve bëhet nga drejtuesi i mbledhjes, me pëlqimin e anëtarëve të KZAZ-së.
2. Të drejtën e propozimit për mbylljen e diskutimeve e ka çdo anëtar i KZAZ-së.
3. Pas mbylljes së diskutimeve, drejtuesi i mbledhjes paraqet me radhë propozimet dhe fton anëtarët e KZAZ-së për të votuar për secilin propozim.
4. Votimi në KZAZ-është i hapur. Votimi bëhet me ngritjen e dorës ose me deklaram.
5. Anëtari i KZAZ-së voton “pro” ose “kundër”. Abstenimi nuk lejohet. Nëse kërkon, anëtari i KZAZ-së ka të drejtë të shpjegojë votën.
6. Sekretari i KZAZ-së shënon në Librin e Protokollit të Mbledhjeve rezultatet e votimit për çdo propozim.
7. Kur KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës, çështja dërgohet nga Kryetari ose të paktën dy anëtarë të KZAZ-së, brenda 24 orëve, për shqyrtim nga Komisioneri. Vendimim i Komisionerit është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga KZAZ-ja.

Neni 24

Vendimmarrja

1. Vendimet e KZAZ-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote.
2. Sekretari i KZAZ-së, jo më vonë se 24 orë nga marrja e vendimit, kryen zbardhjen e vendimit sipas formatit të miratuar me vendim të KQZ. Vendimi hartohet në numër kopjesh për numrin e subjekteve të interesuara, dhe për t’u administruar në arkivin e KZAZ-së.
3. Vendimet e KZAZ-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve të KZAZ-së, krahas nënshkrimit të tij në vendim deklaron votën “pro” ose “kundër” si dhe arsyetimin përkatës. Vendimet vulosen me vulën e KZAZ-së nga sekretari.
4. Vendimet e KZAZ-së shoqërohen me mendimin e pakicës nëse ka të tillë.
5. KZAZ-ja është e detyruar t’i bëjë publike vendimet e marra, të dërgojë kopje të tyre në KQZ, dhe t’i japë subjekteve zgjedhore ose vëzhguesve të akredituar kopje të vërtetuara të tyre pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës.

Neni 25



E drejta e ankimit

1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtën e ankimit në KAS kundër vendimeve të KZAZ-së, që çenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.
2. Kundër vendimit të KZAZ-së për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njëjësive të qeverisjes vendore nën juridiksonin e saj, të marrë sipas nenit 122 të Kodit Zgjedhor, mund të paraqitet ankimi në KAS jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor.
3. Në çdo rast ankimi për pavlefshmëri, sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor dhe ankimi për ndryshimin e tabelës së rezultatit paraqitet në të njëjtën kërkesë ankimore, sipas paragrafit 2 të këtij neni. Në kërkesë përcaktohen qendrat e votimit, për të cilat kërkohet ndryshimi i rezultatit apo pavlefshmëria.
4. Të drejtën e ankimit sipas paragrafit 1 të këtij neni e kanë edhe individët të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor, si dhe subjektet e përmendura në nenin 6 të Kodit Zgjedhor, kundër refuzimit të kërkesave për akreditim të vëzhguesve, në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve.

Neni 26

Konflikti i interesit

1. Anëtari i KZAZ-së, që është në kushtet e konfliktit të interesit të parashikuar në nenin 32, pika 2, të Kodit Zgjedhor, nuk mund të marrë pjesë në shqyrtim dhe marrjen e vendimit.
2. Vota e anëtarit të KZAZ-së që është në kushtet e konfliktit të interesit, dhe nuk është liruar nga detyra, është e pavlefshme dhe nuk llogaritet në kuorum.
3. Anëtari që ka konflikt interesi duhet ta vetëdeklarojë këtë fakt, ose kjo bëhet nga çdo anëtar apo sekretari i KZAZ-së që ka dijeni. Në çdo rast, plotësohet dhe nënshkruhet një deklaratë ku pasqyrohen shkaqet e konfliktit të interesit.
4. Deklarata administrohet nga sekretari i KZAZ-së, i cili njofton menjëherë Komisionerin. Njofimit i bashkëngjitet kopja e deklaramit të anëtarit përkatës dhe sipas rastit të anëtarit që ka dijeni për konfliktin e interesit.

KREU VII

DOKUMENTACIONI I KZAZ-së

Neni 27

Dokumentacioni i punës së KZAZ-së

1. Modelet e vendimeve dhe dokumentacioni i punës së KZAZ miratohen me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Regjistrimi i akteve dhe dokumentacionit në KZAZ bëhet në:
 - a) regjistrin e vendimeve të KZAZ-së;
 - b) regjistrin e korrespondencës.



Miratuar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr.5, datë 20.11.2020 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor"

3. KZAZ, pasqyron veprimtarinë e saj në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe Procesverbalin e Konstatimit.
4. Administrimi dhe dorëzimi në KQZ i dokumentacionit të punës së KZAZ bëhet nga Sekretari i KZAZ-së.
5. Sekretari i KZAZ-së është përgjegjës për administrimin dhe arkivimin e akteve dhe shkresave në dosje të veçanta për:
 - a) vendimet udhëzimet dhe shkresat e dërguara nga KQZ-ja;
 - b) vendimet e marra nga KZAZ-ja. Propozimet e subjekteve zgjedhore për anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve, për anëtarët e GNV-ve, dhe dokumentacioni përkatës, administrohen së bashku me vendimin e KZAZ-së në dosje të veçanta.
 - c) dokumentacionin për ndërhyrjet e Policisë së Shtetit dhe rivendosjen e rendit publik, kur jashtë qendrave të votimit të ZAZ-së është rrezikuar rendi ose është penguar procesi i rregullt i votimit.
 - ç) kërkesat, ankesat apo pretendimet e subjekteve zgjedhore, të cilave sipas rastit, i bashkëngjitet përgjigja shkresore e KZAZ-së.
6. Libri i Protokollit të Mbledhjeve, Regjistri i Korrespondencës, Regjistri i Vendimeve dhe Procesverbali i Konstatimit të KZAZ-së përdoren, administrohen dhe dorëzohen nga Sekretari i KZAZ-së në KQZ.

KREU VIII PËRGJEGJËSI DHE SANKSIONE

Neni 28

Përgjegjësia e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së

Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së mbajnë përgjegjësi penale ose administrative sipas legjislacionit në fuqi për shkeljen e dispozitave të Kodit Zgjedhor.

Neni 29

Sanksionet administrative

1. Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët apo sekretari i KZAZ-së, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë.
2. Shkelja nga ana e Sekretarit të KZAZ-së e rregullave të përcaktuara në nenin 34 të Kodit Zgjedhor, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë ose me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj.
3. Gjoha vendoset nga Komisioneri, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e financës në KQZ.

KREU IX DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

Neni 30

Zhvillimi i mbledhjeve nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik

1. Në rastet e masave të jashtëzakonshme që mund të vendosen për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së fatkeqësisë natyrore apo situatave të pandemive, mbledhjet e KZAZ-së mund të zhvillohen edhe në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. Sekretari i KZAZ-së në bashkëpunim me administratën e KQZ-së bëjnë të mundur përgatitjen e infrastrukturës.



Miratuar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr.5, datë 20.11.2020 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor"

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

2. Sistemi i konferencave duhet të mundësojë identifikimin e pjesëmarrësve nëpërmjet transmetimit audio-video dhe regjistrimin e mbledhjeve. Pjesëmarrësit regjistrohen në platformën e posaçme që menaxhohet nga Sekretari i KZAZ-së dhe marrin akses për zhvillimin e mbledhjes.

Neni 31

Formimi kalimtar i KZAZ-ve

Në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve, përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve.

Neni 32

Shfuqizime

Udhëzimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr.2, datë 25.02.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 33

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



Miratuar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr.5, datë 20.11.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”